

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A. L., nga ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I. O., avokat nga Deçani, kundër të paditurës K.R.M. “Ç.” në ..., të cilën e përfaqëson N. G., punëtor i së njëjtës, për shkak të anulimit të vendimit dhe kthimit në punë, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3023/2014 datë 9.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 4.3.2019, merr këtë

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3023/2014 datë 9.11.2018, në pjesën me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar si kundërligjor vërtetimi – vendimi nr. 395 datë 1 korrik 2009, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit dhe është detyruar e paditura që paditësin ta rikthejë në punë dhe detyrat e punës, ndërsa,

Prishen aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e cila ka të bëjë me atë që paditësit t’i njihen të gjitha të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës dhe detyrimet që e paditura t’ia paguaj të ardhurat personale në lartësi prej 218 €, me kamatë që e cakton banka komerciale në Kosovë, në lartësi prej 3.5%, si për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 1 korrik 2009 e gjerë në kthim, si dhe t’i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 927 €, krejt këto në afat prej 8 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3023/2014 datë 9.11.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.627/2013 datë 5.5.2014, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e

paditësit dhe është anuluar si kundërligjor vërtetimi – vendimi nr. 395 datë 1 korrik 2009, i të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit dhe është detyruar e paditura që paditësin ta rikthejë në punë dhe detyrat e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, t’ia paguaj të ardhurat personale në lartësi prej 218 €, me kamatë që e cakton banka komerciale në Kosovë, në lartësi prej 3.5%, si për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 1 korrik 2009 e gjerë në kthim, si dhe t’i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 927 €, krejt këto në afat prej 8 ditësh, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar, ose ato të prishen dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK -ës, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi te e paditura ka qenë në marrëdhënie pune nga data 19.9.1998, ka punuar në pozitën e inkasantit në Departamentin për Marrëdhënie me Konsumator dhe me marrëveshjen e fundit mbi punësimin, nr. ..., datë ..., të njëjtit i është vazhduar marrëdhënia e punës nga data ... deri më ..., ndërsa me vërtetimin nr. ..., datë ..., paditësi nga e paditura është njoftuar se komform nenit 11 .1 pika (e) të Ligjit Themelor të Punës së Kosovës ( Rregullorja nr. 2001/27), kontrata e punës nuk do t’i vazhdohet për shkak të skadimit të kontratës së punës dhe për shkak të vlerësimit jo pozitiv të punës nga ana e drejtorit ekzekutiv të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave “Ç.” në Gjakovë, sipas së cilës paditësi gjatë periudhës së caktuar gjashtë mujore nuk ka qenë në nivelin e detyrave të punës, ka keqpërdorë mjetet e Kompanisë si në vërejtjen e fundit ... datë 23 maj 2009, nuk ka zbatuar urdhëresat e punës, nuk është përgjigjur në kërkesën e punëdhënësit nr. ..., datë ..., dhe në mënyrë të paautorizuar ka dëmtuar imazhin duke dezinformuar në mjetet e informimit publik. Paditësi me shkresën e datës 2.7.2009, ka kontestuar vërtetimin për mos vazhdimin e kontratës së punës. Pastaj, paditësi ka

paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në kundërshtim me dispozitat ligjore, dhe të detyrohet e paditura ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë C.nr. 527/2009 datë 29.4.2011, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin Ac. nr. 292/2011 datë 9.7.2012, ka pranuar të gjitha konstatimet juridike të gjykatës së shkallës së parë dhe ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar. Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin Rev. nr. 417/2012 nuk ka aprovuar qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, ashtu që për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike dhe për këtë arsye nuk ka pas kushte për ndryshimin e aktgjykimit të kundërshtuar, prandaj është dashur që dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave ka vërtetuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar, ngase vërtetimi mbi ndërprerjen e punës është i pa qëndrueshëm, andaj ka detyruar të paditurën më afër përshkruar si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të gjykatës ankimore aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje thelbësore të procedurës kontestimore për të cilat ajo gjykatë ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadija e paditësit që ka të bëjë me anulimin si të kundërligjshëm të njoftimit për shkëputjen e marrëdhënies së punës dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës është e bazuar.

Pretendimin e të paditurës të theksuar në revizion se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 2 të LPK –ës, ngase siç theksohet, aktgjykimit të kundërshtuar i mungon arsyetimi për çështjet kryesore në të cilat është bazuar aktgjykimi, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje të tilla të procedurës, sepse aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe është në pajtim me provat e administruara. Aktgjykimi i kundërshtuar ka arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë e cila ka vërtetuar se gjatë regjistrimit të jashtëzakonshëm të inkasantit – këtu paditësit dhe nga ekspertiza financiare është vërtetuar se në regjistrimin e jashtëzakonshëm më datë 7.5.2009 diferenca e të hollave ka qenë 0,35 cent, ndërsa në regjistrimin e dytë të jashtëzakonshëm, më datë 29.6.2009, shuma e dalë më tepër ka qenë 1.15 cent dhe në veprimet e paditësit nuk janë vërtetuar pretendimet e të paditurës se punëtori – këtu paditësi gjatë periudhës së caktuar gjashtë mujore nuk ka qenë në nivelin e detyrave të punës. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësi me marrëveshjen mbi punësimin, nr. 6/20 datë 5.1.2009 te e paditura ka themeluar marrëdhënien e punës në kohëzgjatje nga data 1.1.2009 deri më 30.6.2009. Punët të cilat i ka kryer paditësi në vendin e punës në të cilin është sistemuar nuk janë të natyrës së përkohshme apo të kohëpaskohshme, por të natyrës së përhershme. E paditura me kontratat nga viti 1998 ia ka vazhduar paditësit marrëdhënien e punës për kohë të caktuar, ndërsa kontratat e tilla janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Rregullores nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, ngase detyrat nga vendi i punës kanë qenë të natyrës së përhershme dhe në vendin e tij të punës pas largimit të paditësit nga puna janë pranuar ndër vite edhe 13 inkasant të tjerë, andaj arsyet e paraqitura për mos vazhdimin e kontratës së punës për paditësin janë të pabazuara. Një kontratë e tillë është jo vetëm në kundërshtim me dispozitat e përmendura juridike, por edhe me parimin ndërgjegjshmërisë dhe nderit – bona fide, kur paditësi është mbajtur në një gjendje pasigurie juridike, prandaj gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë konkluduar se arsyeja mbi të cilën paditësit nuk i është vazhduar kontrata e punës, sipas gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë qëndruar.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimin e cekur në revizion se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban arsyetim, mirëpo në revizion nuk është cekur asnjë pretendim konkret se për cilat fakte aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban arsyetim. Sipas vlerësimit të kësaj

Gjykate, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmbajnë arsye të mjaftueshme për një gjykim të drejtë e të bazuar në ligj.

Nga vërtetimi ( njoftimi) i të paditurës nr.395 datë 1 korrik 2009, del se paditësit kontrata e punës nuk i është vazhduar konform nenit 11.1 pika (e) e Ligjit Themelor të Punës në Kosovë (Rregullorja e UNMIK –ut nr. 2001/27), ndërsa në nenin e cekur nuk ekziston pika (e), por nga arsyetimi i vërtetimit – njoftimit del se e paditura kontratën e punës nuk e ka vazhduar, paraparë sipas pikës (d) të nenit të cekur – me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit dhe shkeljet e pretenduara në vërtetimin e cekur.

Thëniet e të paditurës të theksuara në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë të kundërligjshme, Gjykata Supreme e Kosovës, i vlerësoi si të pabazuara, ngase, me të drejtë gjykatat e instancës më të ulët kanë konstatuar se kundër paditësit nuk është zhvilluar procedurë disiplinore për të vërtetuar përgjegjësinë eventuale të tij dhe nuk është zbatuar neni 11.5 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë kanë konstatuar se e paditura me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës paditësit nuk ka vepruar konform nenit 11.5 të Rregullores së cekur për Ligjin Themelor të Punës, andaj edhe pretendimi i të paditurës se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, është i pabazuar.

Ndërsa, tani për tani sa i përket pjesës që ka të bëjë me njohjen e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjendja faktike, nuk është vërtetuar drejt dhe për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e aktgjykimit, kështu që dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët në këtë pjesë janë prishur dhe lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi se pjesa e kërkesëpadisë që ka të bëjë me atë që paditësit t'i njihen të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, dhe të obligohet e paditura që paditësit t'ia paguaj të ardhurat personale në lartësi prej 218 €, me kamatë që e cakton banka komerciale në Kosovë, në lartësi prej 3.5%, si për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar,

duke filluar nga data 1 korrik 2009 e gjerë në kthim, si dhe t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 927 €, krejt këto në afat prej 8 ditësh, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, është e paqartë dhe e pa ekzekutueshme, ngase nuk mund të kuptohet se cilat të drejta dhe detyra t'i njihen paditësit nga marrëdhënia e punës dhe shuma prej 218 € a paraqet shumën e përgjithshme apo shumën mujore të cilën duhet të obligohet e paditura për pagesë, si dhe nga cila datë duhet të fillojë pagesa dhe deri në cilën kohë duhet të përfundojë. Gjithashtu vendimi mbi përcaktimin e kamatës është i paqart dhe në rigjykim duhet të përcaktohet në mënyrë precize obligimi i të paditurës për pagesën e kamatës në shumën e borxhit .

Nga fakti se një pjesë e aktgjyqimit të gjykatave të instancës më të ulët është refuzuar dhe një pjesë të aktgjyqimit është kthyer në rigjykim, mund të ndryshohet edhe kërkesa e palëve lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, andaj u deshtë që aktgjyqimet edhe në këtë pjesë të prishen, ndërsa gjykata në rigjykim duhet të vendosë në bazë të kërkesës së palëve dhe provat e prezantuara lidhur me shpenzimet e bëra.

Nga sa u tha më lart, e me zbatimin e nenit 222 dhe 223 pa. 1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 4.3.2019, Rev.nr.21/2019

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku